



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

DREJTORIA PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE

**Për: Z. Haziz Krasniqi , Zyrtar i Lartë për Raportim dhe Informim
Koordinator për Performancë**

Nga : Procesmbajtëse ,Kumrije Bytyqi ,Drejtore she ne Qendrën per pune sociale ,

Lënda: Proceverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë

Plani i Punës per Ekipin Komunal per te Drejtat e Fëmijëve (2024-2026)

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Planit të Veprimit për Ekipin Komunal për të drejtat e fëmijëve

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Publikimet:

Ky dokument është në konsultim publik nga **29.04.2024 dhe zgjat deri me 15.05.2024** në web faqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:15

Konsultimi publik është hapur nga z. Haziz Krasniqi Zyrtar i Lartë për Raportim dhe Informim njeheritë , Koordinator për Performancë Komonale : I përshëndes te gjithë pjesëmarrësit dhe i falënderoj ju falënderoj te gjithëve qe keni gjete kohe te merrni pjese ne ketë konsultim Publik .

Sikurse edhe dokumentet tjera edhe dhe plani dhe plani i veprimit për ekipin komunal per te drejtat e fëmijëve (2024-2026) kryetari i komunës ka vendosur ketë dokument ta ve ne konsultim publik dhe te merren komente sugjerime apo edhe vërejtje eventuale nga ana juaj.

Ky dokument është në konsultim publik nga **29.04.2024 dhe zgjat deri me 15.05.2024** në web faqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike: Kërkoj qe komentet dhe sugjerimet ti dërgohen ne e-mailin e zyrtareve deri me 15.05.2024 ora 16.00 tek kumrije.bytyqi@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Unë nuk po vazhdoj me tutje fjalën per prezantim ja jap Bashkimit.

Bashkim Rakaj: ju përshëndes unë do te beje prezantim ne pika te shkurta pasi dokumenti është në konsultim publik i njëjti është i publikuar ne organet per dëgjim publik.. Rëndësia e Planit i veprimit për ekipin komunal per te drejtat e fëmijëve derivon nga ligjet , udhëzimeve administrative kryesisht Ligji per mbrojtjen e fëmijëve nga konventat ndërkombëtare per drejtat e fëmijëve e cila obligon komunën per themelimin e

ekipit per mbrojtjen fëmijëve. Komuna Prizrenit ka treguar seriozitet ne ndërtimin e ekipi duke parashikuar planin dhe një ser mekanizma tjera te cilat derivojn nga Ligji per mbrojtjen e fëmijëve. Janë identifikuar 6 fusha të veprimit në kuadër të planit të punës, të cilat rrjedhin nga Ligji për Mbrojtje e Fëmijës gjithashtu është parashikuar edhe buxhet .Keto fusha janë:

- Shërbimet cilësore gjithëpërfshirëse për fëmijë;
- Vetëdijesimi dhe evokimi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës;
- Hapësirat e sigurta dhe miqësore për fëmijë;
- Aktivitete: Sportive, kulturore, edukative, lojëra dhe rekreative për fëmijë
- Pjesëmarrja e fëmijëve
- Implementimi, monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Ekipi ka shpreh një interesim te veçante me puno ne ketë plan te veprimit si dhe akteret komunal nder sektorial dhe drejtorit komunale kane shprehur seriozitet si dhe interes te veçante ne hartimin e këtij plani si dhe kryetari i komunës ka përkrahur zbatimin e këtij plani dhe implementimin e shërbimeve sociale te fëmijëve te cenusshëm dhe fëmijët e komunës se Prizrenit .

Haziz Krasniqi: sa per informata per mbajtjen këtij konsultimi publik te Plani i veprimit për ekipin komunal per te drejtat e fëmijëve është duke u mbajtur procesverbal i njëjti do te publikohet ne web faqen e komunës .Gjithashtu do te hartojmë edhe një raport me te gjitha detajet ne ketë raport do merren te gjitha komentet te cilat jepen sot apo te dërgohen përmes platformës elektronike apo edhe ne formë fizike Te gjitha afatet kohore te publikuara dhe njoftimet janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe afatet e rregullta kohore .andaj i ftoj te gjithë pjesëmarrësit te kontribuojnë ne ketë debat.

Bashkim Gashi, qytetarë: E përgëzoj ekipin punues per punën qe keni bere. Te gjitha qeshjet dalin nga Ligjet per mbrojtjen e fëmijëve .Janë te përfshira disa fusha dhe disa fusha nuk janë te përfshira. Ky plan ka pas parasysh me shume kompetencat e komunës ,aktivitete konkrete dhe kohen e realizimit .Duhet me pas fokus , teknologjinë informativ , rrjetet sociale deri te inteligjencë artificiale qe ndikojnë negativisht tek fëmijët te cilat ne aspektin psikik kane pasoja sidomos fëmijët nga mosha një vjeçare ku nenat i japin telefonat per ti mashtruar jo me qellim por duhen me pas kujdes një gjë e tillë ndodh edhe me fëmijët me karroca qe përdorin telefonat.

Gjithashtu edhe fëmijët i keqpërdorin rrjetet sociale te cilët i qojnë deri te krimet e ndryshme e qe shpesh kane ndikim edhe platformat tjera keqpërdorimit e qe tek fëmijët janë evidente ku do. Pasi janë evidentet nga një numër i madhe i fëmijëve dhe nuk janë përfshire aktivitetet e keqpërdorimeve te ndryshme me aktivitete te veçanta si droga etj. Një propozim konkrete është te formohen grupet per drejtat e fëmijëve pasi ne disa shkolla janë formale vetëm ne letra kane mbet andaj te monitorohen shërbimet nga vete këto grupe te formuara ne shkolla pasi psikologu ,pedagogu ,drejtori i shkollës nuk munde te jene aq afër fëmijëve .Pra te behet zgjedhja e rasteve nga vet fëmijët

Te ketë transparenca me e madhe ne pune te raportohet te mbahen debate ne mënyre permanente. Ose te mbahen debate me këshillin e prindërve ,këshillin e fshatrave ,infrastrukturë ,parqe ,gjelbërim .Te mbahen takime te rregullta me OJQ me shërbimet sociale mos te dyfishohen shërbimet dhe aktivitetet .

Gjithashtu te bashkëpunojnë organizatat me qellim qe gjate tere kohet te organizohen dhe te bashkëpunojnë me ekipin per drejtat e fëmijëve.

Hazizi Krasniqi :Faleminderit Bashkim

Bashkimi Rakaj : faleminderit per kontributin sikur se me pas qene anëtar i ekipit por janë paraparë te gjitha aktivitetet psh. rrjetet sociale ne kemi paraparë ne piken e veçante pri nderimi i mire dhe disiplinat pozitive te pri nderimit. Ne do ti zbatojmë ketë plane gjithmonë duke u bazuar ne Ligje ,rregullore ,udhëzime administrative .

Muhamet Shala : ju përgëzoj per planin e veprimit për ekipin komunal per te drejtat e fëmijëve pasi po ballafaqohemi me probleme te ndryshme te fëmijëve unë mendoj se është e nevojshme te ndërtohet një qendre per mbrojtjen e fëmijëve me kuptimin e Qendrës transit kur fëmijët kane probleme me prindërit. Per shkak te specifikave te problemeve te ndryshme strehimorja per mbrojtjen e fëmijëve është me se e domosdoshme te ndërtohet ne qytetin e Prizrenit.

Gjithashtu ndërtimi i një strehimore per strehimin e fëmijëve pa kujdes prindëror me një staf te përgatitur profesional do te kontribuonte ne mërqinjën e fëmijëve.

Bashkimi Rakaj :sa per njohurin tuaj Komuna Prizrenit ka ndare buxhet per ndërtimin e nje qendre te tille , por jemi ne pritje te Ministres te bazohemi ne një Plan per ndërtimin e kësaj qendre per Mbrojtjen e fëmijëve. Ne jemi komuna e pare qe ka ndare buxhet per mbrojtjen e fëmijëve.

Erolli Shabani, nga Organizata” Ec ma ndryshe: ju lutem ma shpjegoni çka keni kuptuar me shumen buxhetore 5.400 dhe shumat tjera te parapara ne buxhet. Te narrativi me pas pjese edhe pjesa e trashëgimish kulturore si qytet historik pasi Prizreni njihet si qytet me vlera kulturore. Ne ketë plan se kame vërejt promovimin dhe mbrojtjen e mjedisit .

Bashkim Rakaj: Implikimet buxhetore janë te parapara ne planin tre vjeçar pasi kemi bere një parashikim nga eksperti i cili ka punuar ketë plan per ndarjen buxhetore .Sa i përket pjesës se trashëgimish kemi me paraparë ne plan dhe sa i përket pjesës se mjedisit është i paraparë ne plan..

Mybexhele Zhuri: siç e dini ne nuk kemi pasur as Ligjin per mbrojtjen e fëmijëve ne i kemi paraparë disa fusha por plani do te rishikohet dhe do te merren parasysh edhe këto rekomandime ne te ardhmen te inkorporohen ne ketë plan.

Hazizi Krasniqi ; nëse nuk ka me pyetje dhe komente e mbylli ketë takim duke ju falënderuar per pjesëmarrjen dhe kontributin tuaj gjithashtu ju njoftoj edhe njëherë se është i hapur konsultimi publik nga **29.04.2024 dhe zgjat deri me 15.05.2024** në web faqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike: Kërkoj qe komentet dhe sugjerimet te dërgohen ne e-mailin e zyrtareve deri ora 16.00 me kumrije.bytyqi@rks-gov.net dhe Haziz.Krasniqi@rks-gov.net.

Ju faleminderit!